



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	
Nr.	prot.

Data: 25.2.2025

Nr: 170

Ora: 14:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA PËR MBROJTJEN  
E TË DREJTAVE TË PUNËTORËVE TË SHQIPËRISË”, ME KRYETAR Z. KADRI  
ISUFAJ, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR  
KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 25.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën nr. 983 Prot., datë 13.2.2025, me:

- KËRKUES:** Partia politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, me kryetar Z. Kadri Isufaj
- OBJEKTI:** Regjistrimi i partisë politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025
- BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

**V Ë R E J:**

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Data: 25.2.2025 Nr: 170  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, me Kryetar Z. Kadri Isufaj, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

“Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, nëpërmjet Kryetarit Z. Kadri Isufaj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend. që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 31.12.2024, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, me iniciale “P.M.D.P.SH”, me Kryetar Z. Kadri Isufaj, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë” me shkronja nistore “P.M.D.P.SH”, me adresë: Rruga “George W. Bush”, H. 3, Kt. 2, Zyra nr. 110, përballë godinës së Parlamentit, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Kadri Isufaj, me adresë: Rruga “George W. Bush” H. 3, Kt. 2, Zyra nr. 110, përballë godinës së Parlamentit”, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Z. Ymer Kaceli, me adresë: Rruga “Punëtorët e Rilindjes”, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në, është Z. Kadri Isufaj, me adresë: Rruga “George W. Bush” H. 3, Kt. 2, Zyra nr. 110, përballë godinës së Parlamentit”, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë” respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit

të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025”.

### **V E N D O S :**

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, me kryetar Z. Kadri Isufaj, me shkronjat nistore “P.M.D.P.SH”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**